



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/28

Datë: 08.05.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet 22 dhe 23 të Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/28

Datë: 08.05.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011 në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/28

Datë: 08.05.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011 në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Strategjia Kombëtare dhe Planit i Veprimit Kundër Trafikimit më Njerëz për vitet 2015-2018.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 04/28

Datë: 08.05.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011 në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet hostimi i Regjistrimit Qendror të lejeve dhe licencave që lëshohen nga Institucionet Qendrore të Republikës së Kosovës në domenin Qeveritar të Republikës së Kosovës.
2. Regjistri Qendror i Lejeve dhe Licencave do të jetë në kuadër të ueb faqes së Zyrës së Kryeministrit me këtë link: <http://lejelicenca.rks-gov.net>
3. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit që ta përditësoj në baza të rregullta Regjistrin Qendror të Lejeve dhe Licencave.
4. Obligohen të gjithë udhëheqësit e institucioneve përkatëse që lëshojnë leje dhe licenca të dërgojnë të dhënat e kërkuara në Zyrën Ligjore - ZKM, me qëllim të përditësimit të Regjistrimit Qendror të Lejeve dhe Licencave.
5. Të gjitha llojet e lejeve dhe licencave të cilat nuk figurojnë në Regjistrin Qendror të lejeve dhe licencave nuk kanë efekt juridik.
6. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi dhe të Rregullores (QRK) - Nr. 06/2015 për regjistrin qendror të llojeve të lejeve dhe licencave, janë sekretaret e përgjithshëm dhe pozitat e barasvlershme, drejtorët si dhe udhëheqësit tjerë të institucioneve qendrore që lëshojnë leje dhe licenca.
7. Regjistri Qendror i lejeve dhe licencave do të testohet për periudhë një (1) mujore nga momenti i hostimit në domenin Qeveritar.
8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 05/28

Datë: 08.05.2015

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror dhe Rregullores QRK-Nr.17/2013 për Punën e Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror, Vendimit të Qeverisë nr. 12/67 të datës 21.03.2012, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. I vazhdohet mandati anëtarëve të Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror, në këtë përbërje:

1.1. Z. Murat Meha, Agjencia Kadastrale e Kosovës,	Kryesues;
1.2. Z. Besim Kajtazi, Zyra e Kryeministrit,	anëtar;
1.3. Z. Shaban Guda, Ministria e Punëve të Brendshme,	anëtar;
1.4. Z. Sylë Ukshini, Ministria e Punëve të Jashtme,	anëtar dhe
1.5. Z. Tefik Basha, Universiteti i Prishtinës,	anëtar.
2. Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit nga pika 1. e këtij vendimi kryejnë detyra në pajtim me Ligjin Nr.04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror.
3. Obligohen të gjitha institucionet kompetente që ta ndihmojnë Komisionin në kryerjen e detyrave të tij.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/28


Datë: 08.05.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011 në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 40,000,00 (dyzet mijë) euro, për përmbushjen e kontributit vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2014 në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal, me seli në Sarajevë, respektivisht në buxhetin e Sekretariatit të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC) e cila shumë formalisht është përcaktuar në Takimin e Tryezës Rajonale të Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore në Bukuresht, në nëntor të vitit 2006.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Rezerva e Qeverisë, nën-programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 131 dhe barten në OB me kod 201 Ministria e Financave, nën-programi Thesari, me kod 112, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere dhe barten në xhirologarinë e Sekretariatit të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC).
3. Obligohet Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë